

Promoting good governance
and Roma empowerment
at local level

Qershor 2020

ROMACTED me një vështrim: SHQIPËRIA

Takimet e para me 250 këshilltarë vendorë në bashkitë e përzgjedhura partnere në Shqipëri u organizuan në mbledhjet e këshillave vendorë gjatë janarit dhe shkurtit 2018. Këto takime përforcuan legjitimitetin e shtatë bashkive partnere për një mbulim të rëndësishëm të programit në nivel vendor.

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri nga Tirana është organizata mbështetëse dhe zbatuese e këtij programi në Shqipëri. Ky program bashkërendohet dhe monitorohet nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë. Ndërhyrjet vendore janë kryer nga një ekip prej tetë lehtësuesish dhe janë mbështetur në terren nga një grup ekspertësh për çështjet rome.

Trajnimi kombëtar mbi planifikimin strategjik me pjesëmarrje u organizua në 21 shkurt 2018, pasuar prej konferencës së parë hapëse të programit, e cila u mbajt më 22 shkurt 2018. Një kuadër tripalëshe midis Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkive Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Roskovec, Vlorë dhe Përmet u nënshkrua për zbatimin e Programit ROMACTED. Kjo veprimtari shërbeu si një platformë për shkëmbimin ndër-institucional dhe bashkërendimin për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë.


Veprimtaritë prezantuese vendore u zhvilluan gjatë muajve prill-maj 2018 me qëllim nxitjen e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome për integrimin e romëve në të shtatë këto bashki. Këto veprimtari përfshinë një audiencë prej 835 anëtarësh nga komunitetet rome, autoritetet vendore, organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të vendore.

Trajnimi i dytë kombëtar mbi "Hartimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin e Romëve në Nivel Vendor" u organizua më 12 shkurt 2019 në Tiranë. Ai pati për qëllim të ndërtonte kapacitetin e autoriteteve vendore dhe komuniteteve rome për të përgatitur dhe zbatuar planet dhe projektet për përfshirjen e romëve.

Tre takime të Grupit Këshillimor janë bërë në Shqipëri deri më tani: më 13 nëntor 2018, 25 prill 2019 dhe 14 nëntor 2019. Aktorët kryesorë patën mundësi të diskutonin për ecurinë e zbatimit të programit, zhvillimin e Planeve Vendore të Veprimit dhe buxhetin me përgjigjshmëri rome.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në linjë të udhëzimit të përgatitur nga Integrimi Rom/RCC, ROMACTED në Shqipëri hartoi një Udhëzues për Buxhetimin e Përgjigjshëm Rom në Nivel Vendor. Trajnimi i tretë kombëtar i zhvilluar në Elbasan në 12-13 shkurt 2020 synoi të diskutonte dhe të konsultojë Udhëzuesin paraprak me përfaqësuesit e shtatë bashkive partnere në Shqipëri. Pas trajnimit kombëtar për romët dhe egjiptianët, rekomandimet e ROMACTED mbi integrimin e objektivave për romët dhe egjiptianët u miratuan në kuadrin e Udhëzimit zyrtar Nr. 10 datë 28/02/2020 mbi "Përgatitjen e Buxhetit Afat-Mesëm 2021-2023" për njësitë vendore vetëqeverisëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri. U zhvilluan shtatë uebinare mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Rom në Nivel Vendor në partneritet me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për të kontribuar në integrimin e projekteve përparësore rome dhe egjiptiane në procesin vjetor të buxhetit për 2021 dhe për buxhetin afat-mesëm për periudhën 2021-2023.

Që të shtata bashkitë partnere në Shqipëri përfaqëuan metodologjinë ROMACTED dhe miratuan Planet Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 në këshillat e tyre vendore të bashkive gjatë 2019-2020.



Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe



PËRGATITJA E PROCESIT

U ngritën 22 Grupe Komunitare të Veprimit (GKV) në nivel lagjeje dhe shtatë në nivel bashkie. Shtatë Grupe Institucionale Pune dhe shtatë Grupe Task-Force u ngritën zyrtarisht, pothuajse njëherazi në të shtatë bashkitë. Numri mesatar i anëtarëve të komunitetit rom që marrin pjesë në GKV është dhjetë (3-5 gra mesatarisht).

Kryebashkiakët e shtatë bashkive pjesëmarrëse deleguan pikat e kontaktit për zbatimin e programit.

Që nga krijimi i Grupeve Komunitare të Veprimit (GKV), Grupeve Institucionale të Punës (GIP), si dhe Grupeve të Task-Forcës në nivel Bashkie (GTB) në gjashtë muajt e parë të 2018 në Shqipëri, u zhvilluan 155 takime të GKV-ve, 131 takime të GIP-ve dhe 121 takime të GTB-ve nga ekipi mbështetës mbi dinamikën e nevojave vendore rome, duke i përkthyer ato në masa për zgjidhje të përshtatshme sipas katër hapave metodologjikë të ROMACTED.



VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PRIORITETEVE

Vlerësimi fillestar i gjendjes në komunitetet rome dhe në bashki u krye gjatë fazës fillestare nëpërmjet mbledhjes së të dhënave për sondazhin bazë në shtatë bashkitë pjesëmarrëse.

U përgatitën këto dokumente vendore të ROMACTED si pjesë e procesit të përgatitjes së Planeve Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në bashkitë partnere:

1. Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
2. Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
3. Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët që kontribuojnë në arritjen e përmbushjes së nevojave kryesore;

Këto dokumente u përgatitën dhe u finalizuan në vitin 2018 dhe në gjysmën e parë të 2019-ës.



MIRATIMI I NJË PLANI TË PËRBASHKËT VEPRIMI

Shtatë vendime u morën në nivelin e qeverisjes vendore për të miratuar Planet Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në këshillat e bashkive gjatë 2019-2020.

1. Plani Social 2019 -2022 i Bashkisë Roskovec u miratua nga Këshilli i Bashkisë Roskovec me Vendimin Nr. 47, datë 17 maj 2019;
2. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 u miratua nga Këshilli i Bashkisë Fier me Vendimin nr. 73, datë 18 qershor 2019;
3. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Përmet me vendimin nr. 109, datë 19 dhjetor 2019.
4. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec Nr. 22, datë 28 janar 2020.
5. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vlorë Nr. 15, datë 27 shkurt 2020.
6. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 u miratua nga Këshilli i Bashkisë Elbasan me Vendimin nr. 43, datë 30 prill 2020;
7. Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 u miratua nga Këshilli i Bashkisë Korçë me Vendimin nr. 47, datë 29 maj 2020;

Shtatë Planet Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 janë buxhetuar sipas zërave të buxhetit dhe buxhetit afat-mesëm të bashkive.



FINANCIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTIT

Sa i përket thirrjes së saj për aplikime për grante për 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë caktoi 720 milion Lekë shqiptare për 61 bashkitë shqiptare. Lehtësuesit ROMACTED inkurajuan bashkitë partnere të përfshinin familjet rome dhe egjiptiane në projekt propozimet e tyre si përfitues. Katër projekte u paraqitën nga Bashkitë Pogradec, Korçë, Fier dhe Vlorë. 61 familje rome dhe 97 familje egjiptiane po përfitojnë tani nga projektet për përmirësimin e kushteve të strehimit të komuniteteve të prekshme në këto katër komuna.

Të shtata bashkitë pjesëmarrëse në Shqipëri paraqitën propozime dhe po zbatojnë projekte sipas skemës së vogël të granteve të ROMACTED-

U zbatuan 14 nisma afat-shkurtra (dy për çdo bashki partnere) me mbështetjen e Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA).

Plani Social Vendor 2019-2022 i përgatitur me mbështetjen e Programit ROMACTED ndihmoi Bashkinë e Roskovecit të aplikojë për fonde. Menjëherë pas miratimit të Planit Social, Bashkia aplikoi dhe fitoi këto dy projekte:

1. "Në kafenenë e gjyshit" me një shumë prej 3,861,750 lekësh nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; dhe
2. "Qendra e Kujdesit Ditor për Personat me Aftësi të Kufizuara" me një shumë prej 4,291,034.00 lekësh të financuara nga UN Albania.

OSHC-të vendore në Bashkinë Korçë u mbështetën nga Lehtësuesja ROMACTED në aplikimin e projekteve të ndryshme të BE-së dhe organizata të ndryshme (Fondacioni i të Rinjve të Ballkanit, Erasmus, dhe World Vision, që adresuan punësimin dhe trajnimin e të rinjve). Dy nga projekt propozimet u miratuan, kurse një tjetër kaloi vetëm fazën e parë

Sinergjitë dhe Bashkëpunimi

Autoritetet publike dhe Organizmat e Barazisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si homologu institucional qeveritar dhe në rolin bashkërendues ndër-sektorial të kuadrit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën E Shqipërisë 2016-2020;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financave Vendore- bashkëpunim në procesin e përgatitjes së Udhëzimit për Buxhetimin e Përgjigjshëm Rom në Nivel Vendor dhe në miratimin e rekomandimeve të ROMACTED në Udhëzimin zyrtar Nr.10, datë 28 shkurt 2020, mbi "Përgatitjen e Buxhetit Afat-Mesëm 2021-2023" për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Drejtorja e Strehimit – Programi ROMACTED dhe ekspertizë ndërkombëtare në hartimin e akteve nënligjore të Ligjit nr. 22/2018 për Strehimin Social brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. U zhvilluan konsultime për aktet nënligjore për strehimin social në Shqipëri për parandalimin e dëbimit të detyruar të grupeve vulnerabël dhe futjen e një kuote prej 5% për përfituesit romë për të gjashtë programet e strehimit. Ky proces u mbështet ndjeshëm nga Programi ROMACTED dhe Programi "Të mos lëmë askënd pas"- Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri;

Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë - konsultime për aktet nënligjore që prekin romët dhe egjiptianët në Shqipëri;

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjeve Vendore për ndarjen dhe integrimin e praktikave dhe modeleve të mira të zbatimit në të shtatë bashkitë të procesit ROMACTED me bashkitë e tjera me popullsi romë;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi - aktivitete të përbashkëta në dhjetor 2019 në Korçë, Pogradec dhe Vlorë në fazën para-përfundimtare të konsultimit të Planeve Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome e Egjiptiane, partnere në veprimtaritë si pjesë e Javës kundër Diskriminimit në shkurt 2020;

Programe të financuara nga BE-ja

"Nisma e përbashkët për fuqizimin e shoqërisë civile rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", zbatuar nga Rrjeti ERGO dhe Roma Active Albania:

- Kryebashkiakja e Roskovecit mori çmimin "Kryebashkiakja më miqësore me romët" në vitin 2019 për Integrimin e Romëve. Ekipi mbështetës i ROMACTED ka qenë i përfshirë aktivisht në inkurajimin e aktorëve vendorë për aplikimin për këtë çmim.
- Lehtësueses ROMACTED iu dha çmimi i BE-së "Heronjtë e Panjohur" për integrimin e romëve në vitin 2019 në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Programi Rajonal i Demokracisë Vendore (ReLoAd) - për thirrjen e dytë për aplikime për organizatat e shoqërisë civile, lehtësuesit ROMACTED organizuan seanca informuese me OSHC-të rome dhe egjiptiane në Elbasan, Korçë, Përmet dhe Roskovec, të cilat janë bashki si të Programit ROMACTED, ashtu edhe të Programit ReLoAd;

Programi "Bashkitë për Evropën", i cili synon 61 bashki në Shqipëri, dha të gjitha të dhënat e mbledhura në 2017 dhe 2018 me qëllim hartimin e Planeve Vendore të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;

"Rinia Ngrihet për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri" zbatuar nga World Vision Albania dhe Rrjeti i të Rinjve të Evropës Juglindore me ndihmë financiare nga Instrumenti Evropian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut të Komisionit Evropian. Organizatat e shoqërisë civile rome në partneritet me bashkitë e Korçës, Vlorës, Elbasanit dhe Fierit u mbështetën në aplikimin për thirrjen e Dytë për Propozime;

Programi "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri" në kuadrin e Instrumentit Horizontal II, bashkërendimi i veprimeve për Javën kundër Diskriminimit në shkurt 2019 dhe reagimi vendor nëpërmjet ndarjes së informacionit mbi masat mbrojtëse ndaj Covid-19 në komunitetet rome në nivelin vendor;

Fondi për Edukimin Rom (REF), "Projekti Rajonal i BE-së për Edukimin e Romëve: Rritja e mundësive të arsimimit për komunitetet rome dhe të rinjë romë në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi" - shpërndarja e informacionit rreth mundësive për arsim në kuadrin e projektit REF.

Organizatave të Shoqërisë Civile rome në nivel vendor

Sinergjitë me organizatat vendore të shoqërisë civile: Së Bashku për Integrimin e Komunitetit Rom, Qendra Sociale Murialdo, Epoka e Re; Njerëzit të Parët, të cilat kanë kontribuar në përgatitjen e Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;

Bashkëpunimi me organizatat vendore të shoqërisë civile rome dhe egjiptiane "Zëri i Barabartë Rom & Egjiptian" dhe "Me komunitetin për ndryshim" përmes punës në terren;

Organizatave vendore të shoqërisë civile rome dhe egjiptiane, Vëllazërinë Egjiptiane dhe Realitetin Rom në Shqipëri, të cilat ofruan kontribute gjatë përgatitjes së Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;

Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit dhe mbështetjes për dy organizata vendore të shoqërisë civile rome, Romano Sezi dhe Lëvizja e Rinisë Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Elbasanit;

Rrjeti rajonal i OSHC-ve rome dhe egjiptiane të mbështetura nga projekti i financuar nga BE ECSORI "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Romëve" zbatuar nga Qendra Shqiptare Kombëtare për Trajnime dhe Asistencë Teknike (ANTTARC) në partneritet me Amaro-Drom dhe AFCR.

Masat për COVID-19



Izolimi i vendosur me urdhër të qeverisë për shkak të Covid-19 preku komunitetet e dobëta rome në Shqipëri. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 236, datë 19 mars në vitin 2020 "Për masat për të ofruar mbështetje dhe ndihmë në shtëpi për grupet në nevojë në rrethanat e shkaktuara nga Covid-19" u fokusua tek familjet e prekshme/individët në nevojë, përfutjesit e ndihmës ekonomike dhe të pastrehët.

Duke qenë se ky vendim i qeverisë qendrore nuk synonte individët/familjet, që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, Bashkia e Fierit në takimin e Këshillit në 7 prill 2020 mori vendimin për të mbështetur individët romë, që nuk u prekën nga vendimi i qeverisë qendrore. Këta individë u mbuluan nga fondi i emergjencës së Bashkisë pasi nuk u regjistruan në skemën social-ekonomike për furnizimet me ushqime dhe për mbështetje me qiranë e muajit prill.

Ekipi ROMACTED mori këto masa në përgjigje të sfidave të Covid-19:

■ Masat e marra në të gjitha bashkitë partnere:

- Ndarja e informacionit në komunitetet rome të bashkive partnere gjatë shpërthimit të Covid-19 në gjuhët rome, shqipe dhe angleze;
- Dezinfektimi i zonave ku jetojnë komunitetet rome dhe egjiptiane në bashkitë partnere për të shmangur përhapjen e virusit pas kërkesave të bëra nga GKV-të;
- Dërgimi i letër-kërkesave shtatë Kryebashkiakëve dhe Grupeve Institucionale të Punës mbi nevojat urgjente të Romëve në bashkitë partnere të ROMACTED

■ Mesat specifike për bashki:

Korçë

- U hartua një listë e familjeve në nevojë rome dhe të moshuarish romë, që kërkojnë mbështetje urgjente;
- Në lagjet e njohura si ish Gjeologjiku, ish Konvikti i Bujqësorës dhe ish Konvikti i Inxhinierisë u shpërndanë 120 paketa ndihme emergjente.

Elbasan

120 paketa ndihme urgjente u shpërndanë në Bashkinë Elbasan, në lagjet e Rapishtës dhe Dyli Haxhire.

Përmet

30 paketa ndihme urgjente u shpërndanë në Bashkinë Përmet në lagjen "Partizani" dhe në Njësinë Administrative të Piskovës.


Roskovec

30 paketa ndihme urgjente u shpërndanë në Bashkinë Roskovec, në lagjen Nr. 1 dhe Liqenin e Kurjanit.

Fier

167 paketa ndihme urgjente u shpërndanë në Bashkinë Fier, në lagjen Levan, Sektor Seman dhe Fermë Clirim.

Grantet e vogla për bashkitë



FIER

Përmirësimi i shkollës
fillore "Trifon Prifti"

VLORE

"Fuqizimi i komunitetit rom
përmes rritjes së aksesit në
tregun e punës, programet e
trajnitimit dhe promovimin e
aftësive profesionale"

ROSKOVEC

Rikonstruksioni i rrugës së
liqenit të Kurjanit (me gjatësi
400m) për përmirësimin e
aksesueshmërisë së banorëve
romë në qendrën e Roskovecit

ELBASAN

"Përmirësimi dhe zgjerimi i angazhimeve,
kapaciteteve, aftësive dhe njohurive të stafit
të qendrës së komunitetit për ofrimin e një
mësimdhënieje cilësore dhe efikase për
fëmijët romë, rehabilitimin e urës që çon
drejt qendrës komunitare"

POGRADEEC

Rindërtimi dhe rehabilitimi i urës
së Kabashit, që lidh zonën e
banuar me Pogradecin

KORÇË

Qasja shumëdisiplinare për mbrojtjen
e fëmijëve në Korçë - Përforcimi i rolit
të rrjetit vendor për mbrojtjen e
fëmijëve (MF) përmes një qasjeje
gjithëpërfshirëse me GKV-të rome
dhe ngritja e njësive të Mbrojtjes së
Fëmijëve në nivel bashkie

PËRMET

Në hapat e Mjeshtreve të
Mëdhenj

